



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

Nr. 454/prot.

Tiranë, më 05.07.2021

Vendim  
Nr. 42 datë 05.07.2021

Për krijimin e njësisë kërkimore të përkohshme  
*Instituti Kombëtar i Fizikës (IKF)*

Referuar nenit 4 pika 6 dhe nenit 19 pikat 1 dhe 3 të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; si dhe neneve 44 e 46 të Statutit të saj, Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 29.06.2021, me propozim të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike:

Vendosi:

1. Krijimin e njësisë kërkimore të përkohshme në fushën e fizikës, me emrin *Instituti Kombëtar Fizikës (IKF, virtual)*;
2. Bordi drejtues i njësisë përbëhet nga këta anëtarë: akad. Rexhep Meidani, akad. Florian Vila, akad. Mimoza Hafizi, prof. Halil Sykja, prof. Ardian Gojani, prof. Orion Çiftja.
3. Përkohësisht IKF do të funksionojë sipas platformës bashkëngjitur. Deri në fund të muajit korrik 2021 bordi drejtues i IKF të miratojë platformën përfundimtare të funksionimit dhe të miratojë statutin.
4. Brenda muajit dhjetor 2021 IKF të ketë përfunduar evidentimin e grupeve kërkimore brenda vendit dhe në vendet fqinje që mund të ofrohen për bashkëpunim, duke finalizuar fazën e parë të anëtarësimit dhe duke realizuar forumin e parë të fizikës.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi kryetari i SSHNT dhe sekretari shkencor.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

